

...: MRT ...:

- Ballina

- Lajme aktuale**

- Maqedoni

- Balkan

- Botë

- Politikë

- Ekonomi

- Stil**

- Shkencë dhe natyrë

- Kulturë dhe shoqëri

- Sport

- Programi**

- TV programi

- Emisione dhe Filma**

- Emisione TV

- Për ne**

- Tani

- Për fillimet e MRT

- Të dobishme**

- Aeroporte

- Trena

- Autobusë

- Kinema

- Teatro

- Telefona të rëndësishëm

Zbulohen dy anije të fundosura në Luftën I Botërore

e hënë , 01 tetor 2007



Pas 92 vitesh nga data e zhdukjes së tyre, janë zbuluar në Gjirin e Vlorës dy anije italiane, të fundosura nga gjermanët në Luftën e Parë Botërore. Dy anijet "Re Umberto", që transportonte trupa ushtarake dhe anija luftarake, "Intrepido" të mbytura në datën 4 dhjetor të vitit 1915, janë dalluar dhe filmuar të dielën. E para në thellësinë 50 metër dhe tjetra në 30 metër. Ka qenë drejtori i Departamentit të arkeologjisë nënujore dhe detare të Institutit. Kombëtar të Arkeologjisë në Tiranë, Adrian Anastasi, i cili ka dhënë të dielën lajmin për këtë gjetje të rëndësishme arkeologjike. Ekspedita për evidentimin e anijeve të mbytura ka nisur që prej 4 ditësh, ndërkohë që dy ditët e fundit janë filmuar dhe fotografuar pjesët e të dy anijeve të mbytura. Sipas ekspertëve, Gjiri i Vlorës fsheh relike të shumta të anijeve italiane të një rëndësie të veçantë historike, të cilat janë fundosur gjatë Luftës së Parë dhe të dytë Botërore dhe lokalizimi dhe identifikimi i tyre merr rëndësi shkencore për të dyja vendet. Sipas Anastasit, zbulimi i këtyre veprave do të jetë një pasuri nënujore me vlera të mëdha për vetë qytetin e Vlorës.

< Mbas

Vazhdoni >

[Kthehuni tek lista]

Јазици / Languages

Shqip (Албански)

Kërkimet

Kërko...



Kontakt

Veb Redaksi

